

Kolonel Fiqiri Hoxha

Tetor 2020 –



Kolonel Fiqiri Hoxha ka lindur më datë 10.01.1969, në Elbasan. Në vitin 1987, kolonel Hoxha ka përfunduar Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë dhe më pas ka kryer studimet në Fakultetin Gjitharmësh pranë Akademisë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë. Ai është titulluar oficer aktiv në specialitetin “Këmbësori” në vitin 1991.

Përpara se të merrte detyrën kryetar i Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, kolonel Hoxha, ka kryer detyrën e shefit të Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes në Komandën e Forcës Tokësore.

Gjatë karrierës së tij ushtarake, kolonel Hoxha ka shërbyer në pozicione të ndryshme në Forcat e Armatosura, si: shef i Departamentit të Operacioneve në Akademinë e Forcave të Armatosura; atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë i akredituar në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Mal të Zi dhe në Bosnje-Hercegovinë; shef Shtabi në Policinë Ushtarake; komandant batalioni në Regjimentin Komando; shef i Degës së Zbulimit në Komandën e Forcës Tokësore; specialist i zbulimit taktik në Brigadën e Reagimit të Shpejtë, si dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.

Kolonel Hoxha ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Lartë të Oficerit dhe Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë së Forcave të Armatosura; Kursin e Zbulimit Taktik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kursin Bazë të Oficerit në shkollën e Këmbësorisë në Turqi si dhe kurse të ndryshme funksionale.

Gjithashtu, Seminarin e Lartë Ekzekutiv, pranë Qendrës Marshall, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake.

Kolonel Hoxha ka kryer dy dislokime në misione ndërkombëtare, si përfaqësues i lartë ushtarak, pranë kontigjentit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Çad, si dhe në Afganistan si oficer shtabi në Degën e Operacioneve dhe Stërvitjes.

Kolonel Hoxha, ka përfunduar “Masterin Shkencor në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes”, pranë Akademisë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.

Kolonel Hoxha flet rrjedhshëm gjuhën angleze dhe turke.

Ai është i martuar dhe ka dy fëmijë.